

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GOTBEK CONSTRUCTION” SHPK**

Në Tiranë, sot me datë 26.06.2024, (dymijë e njëzet e katër), ne të nënshkruarit e mëposhtëm:

- **SKËNDER PASHAJ**, I biri i Imer i datelindjes 23.02.1970, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr personal H 00223181 O.
- **ROBERT ÇINA**, I biri i Pandeli i datelindjes 14.03.1959, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr personal F 90314117 B.
- **FATOS JAUPI**, i biri i Jake i datelindjes 28.06.1955, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr personal G 50628084 E.
- **SOKOL DOÇI**, i biri i Lutfi i datelindjes 30.05.1979, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr personal H 90530006 W.
- **AFRIM VIGANI**, i biri i Masar i datelindjes 21.10.1958, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr personal F 81021056 T.

me cilësinë e “Ortakeve Themelues“, redaktojmë këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë e të sigurtë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, me ndryshimet përkatëse, në ligjin “Për QKB”, krijojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“GOTBEK CONSTRUCTION” sh.p.k.**

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“GOTBEK CONSTRUCTION” sh.p.k.**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **“GOTBEK CONSTRUCTION” sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizik të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë

tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara
Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në, Tiranë, Kamëz, Tiranë, Lagjia Nr.4 Rr. "Kosova", zona kadastrale nr. 2066, me Nr. Pasurie 66/89.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Aktiviteti në fushën e ndërtimit, transportit. Projektim, ndërtim instalim të impianteve të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, të rrjetit ujësjellës kanalizime. Shitblerje dhe dhënie me qera të makinerive e pajisjeve të punës dhe pasuri të paluajtshme. Aktivitet në hoteleri turizëm e agrobiznes. Import – Eksport shitje me shumicë e pakicë, materiale elektrike, ndërtimi, industrial, hidroteknike, makineri e pajisje të ç'do lloji. Studim, projektim, konsulence, raporte, ndërtim në fushat energjetike, mjedis, ujësjellës kanalizime, hidroteknike dhe sektorë të tjerë të industrisë e ndërtimit. Supervizim, mbikqyrje punimesh ndërtimore.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **1.000.000 (njëmilion) lekë** dhe është i përbërë nga **5 (pesë) kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në 5 kuota me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaket e shoqërisë të ndarë në pesë kuota, si më poshtë:

- 1- **SKËNDER PASHAJ**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 34 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 340.000 (treqinddymijë) lekë.
- 2- **ROBERT ÇINA**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 14 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 140.000 (njëqinddymijë) lekë

- 3- **FATOS JAUPI**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 24 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 240.000 (dyqindedyzetmijë) lekë
- 4- **SOKOL DOÇI**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 24 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 240.000 (dyqindedyzetmijë) lekë
- 5- **AFRIM VIGANI**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 4 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 40.000 (dyzetmijë) lekë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërbllimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tre të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesmarrës në mbledhje.

Kuorumi është pjesmarrja e domosdoshme e ortakëve sipas përcaktimeve ligjore.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- C'do ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. AFRIM VIGANI** i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të kufizuara sipas parashikimeve të nenit 11 dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Administratori mund të përfaqësojnë shoqërinë dhe mund të prokurojë të tretë për përfaqësimin e saj.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesën e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Ai ka të drejtë:

- të kujdeset për mbarrëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit;
- punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
- dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shoqëri;
- mbajtjen e korrespondencës së shoqërisë;
- dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të shoqërisë;



- autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të shoqërisë;
- të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të shoqërisë si rezultat i punëve të kryera;
- të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë (Euro, Lekë dhe USD) të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari, deri në një vlerë prej 50,000 Euro (pesëdhjetë mijë euro) ose ekuivalenti i kësaj shume në monedha të tjera.
- Të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negociimin, hartimin dhe lidhjen e çdo lloj kontrate ose marrëveshje në një vlerë prej 50,000 Euro (pesëdhjetë mijë euro) ose ekuivalenti i kësaj shume në monedha të tjera) me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore si dhe çdo subjekt tjetër.

Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë, e cila tejkalon kompetencat e mësipërme Administratori duhet të marrë më parë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët e shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

SKËNDER PASHAJ

Skender Pashaj

ROBERT ÇINA

Robert Çina

FATOS JAUPI

Fatos Jaupi

SOKOL DOÇI

Sokol Doçi

AFRIM VIGANI

Afrim Vigani